



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I Ministrët

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i planit dhe programit për klasën e pestë të mësimi joformal

NUMËR: MASHT 16/2006

DATA: 26.05.2006

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe Shtojcës IV pika (iii) të Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 4, 42 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nenit 1 të Ligjit mbi arsimin dhe aftësimin e të rriturve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është, zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e pestë të mësimi joformal, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Plani dhe programi

Plani dhe programi i ri për klasën e pestë të mësimi joformal i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Zbatimi

1. Ky Plan dhe program për klasën e pestë të mësimi joformal zbatohet nga viti shkollor 2006/2007.
2. Me zbatimin e Planit dhe të programit për klasën e pestë të mësimi joformal, shfuqizohen planet dhe programet e deritashme për klasën e pestë të mësimi joformal të shkollës fillore.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me dt.26.05.2006.

Agim Veliu, ministër